



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

KËSHILLI KONSULTATIV PËR KOMUNITETE
CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES
KONSULTATIVNO VEĆE ZA ZAJEDNICE



RAPORT VJETOR 2024

Prishtinë, 2025

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Këshillit.....	1
Fjala hyrëse e Sekretares së Këshillit	2
I. Përmbledhja ekzekutive	3
II. Themelimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete.....	4
III. Udhëheqja, përbërja dhe struktura organizative e Këshillit Konsultativ për Komunitete.....	4
IV. Statusi dhe Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete:	7
V. Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete	9
VI. Objektivat e Punës për vitin 2024	10
VII. Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese	10
VIII. Organizimi i Seancave të Nominimit me Organizatat Përfaqësuese të Komuniteteve	33
IX. Buxheti i Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe raporti financiar	35
X. Përfundime	36

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Këshillit

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes raportin vjetor të punës së Këshillit, i cili paraqet mekanizmin kryesor për konsultim, bashkërendim dhe shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore.

Raporti pasqyron veprimet dhe aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Këshilli, në drejtim të përmbushjes së kompetencave dhe përgjegjësisve ligjore të Këshillit, si dhe objektivave të punës nga Plani Vjetor i Punës për vitin 2024.

Sikundër edhe viteve të mëparshme, edhe gjatë këtij viti, Këshilli Konsultativ për Komunitete me përkushtim të madh ishte i angazhuar në përmbushjen e funksioneve dhe mandatit kushtetues e ligjor të tij.

Këshilli ka qenë i fokusuar në organizimin dhe në artikulimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre përmes takimeve me përfaqësuesit e institucioneve të shtetit, shqyrtimit dhe dhënies së rekomandimeve në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetet jo shumicë.

Përmbushja e objektivave të identifikuar është fryt i punës ekipore të anëtarëve të Këshillit dhe personelit të Sekretariatit, prandaj përfitoj nga rasti t'ju shpreh mirënjohjen gjithë anëtarëve të Këshillit dhe personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe rezultatet e arritura në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

Veçmas, në emrin tim dhe të anëtarëve të Këshillit, falënderoj Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani Sadriu dhe kabinetin e saj për inkurajimin, përkrahjen dhe mbështetjen e pa rezervë që na kanë ofruar në implementimin e mandatit të Këshillit, duke e shndërruar dhe mbajtur në këtë mënyrë Këshillin ndër mekanizmat institucionalë më të rëndësishëm në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Izudin Sagdati

Fjala hyrëse e Sekretares së Këshillit

Të nderuar anëtarë të Këshillit,

Në përputhje me mandatin, përgjegjësitë dhe detyrat ligjore, Këshilli konsultativ për Komunitete (KKK) ka aprovuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, në të cilin janë përcaktuar objektivat dhe aktivitetet e Këshillit. Në zbatim të këtij plani dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, Këshilli, grupet punuese dhe Sekretariati kanë punuar me përkushtim të madh.

Në kuadër të raportit të përgjithshëm të punës së Këshillit, raporti i punës së Sekretariatit pasqyron në mënyrë të përmbledhur aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Sekretariati në përmbushje të objektivave të Planit të punës për vitin 2024. Personeli i Sekretariatit ka qenë i përkushtuar gjatë gjithë vitit në realizimin e objektivave të caktuara, duke siguruar shërbime profesionale dhe administrative për Këshillin dhe grupet punuese.

Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2024 ka qenë organizimi i procesit të aplikimit dhe nominimit për anëtarë të KKK-së. Ky proces është zhvilluar në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar një përfaqësim të drejtë dhe efektiv.

Duke i realizuar në kohë aktivitetet e planifikuara dhe duke arritur synimet paraprake, Sekretariati ka arritur plotësisht objektivat e punës të përcaktuara me Planin Vjetor të Punës për vitin 2024.

Sukseset në realizimin e objektivave të punës janë rezultat i punës ekipore të personelit të Sekretariatit. Për këtë, dëshiroj t'ju shpreh mirënjohje për angazhimin dhe përkushtimin e tyre në zbatimin e detyrave dhe planeve të punës, duke siguruar funksionimin efikas të Këshillit.

Gjithashtu, në emrin tim dhe të Sekretariatit, falënderoj Shkëlqesinë e saj, Presidenten e Republikës së Kosovës, Dr. Vjosa Osmani Sadriu, dhe kabinetin e saj për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me ne.

Sekretariati mbetet i përkushtuar edhe gjatë vitit 2025 në zbatimin e përgjegjësiave ligjore dhe Planit vjetor të punës, për të siguruar funksionim efikas dhe të mirëfilltë të Këshillit.

Nafiye Gaš

I. Përmbledhja ekzekutive

Për realizimin dhe përmbushjen e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, është i një rëndësie të veçantë ekzistimi i institucioneve dhe mekanizmave të veçantë. Në këtë kuadër, në nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar formimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, në të cilin përfaqësohen nëntë (9) komunitete, me qëllim të realizimit të lirive dhe të të drejtave të pjesëtarëve të tyre. Këshilli vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, ndërsa në përputhje me mandatin kushtetues dhe funksionet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, Këshilli përfshin ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.

Në zbatim të mandatit, përgjegjësi dhe detyrave ligjore, Këshilli ka miratuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, në të cilin janë përcaktuar objektivat e punës dhe aktivitetet për realizim.

Në zbatim të këtij plani dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, Këshilli, grupet punuese dhe Sekretariati, kanë punuar me përkushtim.

Sekretariati i Këshillit ka punuar me përkushtim në sigurimin e mbështetjes profesionale dhe administrative të Këshillit, në sferën e dhënies së këshillave ligjore, përpilimin e rekomandimeve, organizimin e takimeve dhe në menaxhimin e buxhetit të KKK-së.

Në vitin raportues është siguruar pjesëmarrja e përfaqësuesve të organeve dhe institucioneve të tjera në punën dhe aktivitetet e Këshillit, si dhe është thelluar më tej bashkëpunimi me institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe mediat.

Këshilli ka kodin e vet buxhetor. Për vitin fiskal 2024, në kategorinë paga dhe mëditje, janë ndarë 36.861,43 euro, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime janë ndarë 82,390.00 euro. Kërkesat për ekzekutimin e pagave, mëditjeve dhe sigurimin e shërbimeve parashtrihen nga ana e Sekretarit të Këshillit, ndërsa ekzekutimi i kërkesave bëhet nga ana e zyrtarëve përkatës të Zyrës së Presidentit.

II. Themelimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli është themeluar nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 12 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës dhe në bazë të Statutit për themelimin e Këshillit të miratuar me anë të Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. KKK-01-2008, i shfuqizuar me Dekretin Nr. KKK-001-2012, me qëllim avancimi të qasjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në jetën publike, ekonomike dhe sociale në Kosovë.

Vizioni

Një mekanizëm funksional, efektiv dhe i qëndrueshëm në gjendje për të përfaqësuar dhe për të adresuar nevojat, pikëpamjet dhe interesat e të gjitha komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.

Misioni

Misioni i Këshillit është që, si një mekanizëm për konsultim, bashkërendim dhe shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore, t'ju ndihmojë komuniteteve jo shumicë dhe pjesëtarëve të tyre në realizimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe sigurimin e qasjes dhe pjesëmarrjen në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

III. Udhëheqja, përbërja dhe struktura organizative e Këshillit Konsultativ për Komunitete


1. Udhëheqja e Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli udhëhiqet nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe Kryesia e tij në përputhje me nenin 12, pika 4 dhe pika 5 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 12, 13 dhe 14 të Statutit të Këshillit. Kryesia e Këshillit përbëhet nga kryesuesi dhe dy (2) zëvendësit e kryesuesit, të cilët zgjidhen me anë të shumicës së thjeshtë nga radhët e anëtarëve të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Asnjëri nga mbajtësit e këtyre posteve nuk përfaqëson të njëjtin komunitet. Kryesuesi dhe zëvendësit e kryesuesit kanë mandat prej një (1) viti, me mundësi të vazhdimit edhe për një (1) vit tjetër.

2. Përbërja e Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe përfaqësues të Qeverisë, Zyrës së Presidentes dhe agjencive të tjera relevante, siç është përcaktuar me nenin 12 (6) të Ligjit Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, që përfshin:

- nga dy (2) përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali, malazez dhe kroat, prej të cilëve nga një (1) mund të jetë deputet i Kuvendit;
- nga tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një (1) mund të jetë deputet i Kuvendit;
- pesë (5) përfaqësues të komunitetit serb, prej të cilëve dy (2) mund të jenë deputetë të Kuvendit;
- një (1) përfaqësues i lartë i Zyrës së Presidentit;
- tre (3) përfaqësues të lartë të Qeverisë, që caktohen nga ministria apo agjencia, fushëveprimi i të cilave është me rëndësi të veçantë për komunitetet.






3. Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli Konsultativ për Komunitete mbështetet nga Sekretariati, i vendosur në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Këshillit.

Në kuadër të Sekretariatit janë të angazhuar dy (2) zyrtar të lart ligjor për komunitete dhe një (1) zyrtar i lart për komunikim.



Struktura organizative e Këshillit Konsultativ për Komunitete

IV. Statusi dhe Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete:

Statusi i Këshillit

Këshilli vepron nën autoritetin e Presidentit, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.

Pavarësia e Këshillit

Këshilli, në pajtim me mandatin e tij, është i pavarur dhe vepron në emër të vet gjatë miratimit të vendimeve, rekomandimeve apo kur ndërmerr ndonjë veprim.

Vendimet, rekomandimet dhe veprimet e Këshillit nuk do t'i atribuohen Presidentit.

Kryesuesi, zëvendës kryesuesit dhe anëtarët e Këshillit mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet, rekomandimet dhe veprimet që ndërmerr Këshilli, si dhe përgjegjësinë individuale për veprimet e tyre.

Mandati i Këshillit

1. Mandati i Këshillit, siç është përcaktuar me nenin 60 (3) të Kushtetutës, përfshin:
 - 1.1. Ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë;
 - 1.2. Mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;
 - 1.3. Çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me Ligjin.
2. Këshilli gjithashtu ka mandat të përcaktuar me nenin 12 (1) të Ligjit, që përfshin:
 - 2.1. të ndihmojë në organizimin dhe në artikulimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
 - 2.2. Të ofrojë një forum për konsultim dhe bashkërendim ndërmjet komuniteteve dhe të sigurojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, në përputhje me Kodin e Mirësjelljes, që do të miratohet nga Këshilli;
 - 2.3. Të ofrojë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore;
 - 2.4. T'ua ofrojë mundësinë komuniteteve që, në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo të politikave, të cilat përgatiten nga Qeveria dhe Kuvendi, të sugjerojë nisma të tilla dhe që mendimi i tyre të inkorporohet në projekte dhe në programe përkatëse, përfshirë Strategjinë

gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe raportin vjetor gjithëpërfshirës që Qeveria ia paraqet Kuvendit për zbatimin e strategjisë së saj, në pajtim me Ligjin;

- 2.5. Të plotësojë kërkesën për konsultime të tjera të detyrueshme në relacion me akte të caktuara ligjore, që janë paraparë në Kushtetutë dhe ligj;
- 2.6. T'ua mundësojë komuniteteve të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u kushtohen pjesëtarëve të tyre apo që kanë rëndësi të posaçme për ta;
- 2.7. Të japë rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare apo të ndara nga buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve apo interesave të tyre të veçanta;
- 2.8. Të kontribuojë në raportimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës para mekanizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe
- 2.9. Të rrisë vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe të kontribuojë në marrëdhëniet e harmonishme ndërmjet të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Këshillit

1. Këshilli shkëmben informacione me organet përkatëse të Qeverisë dhe institucionet e tjera dhe jep rekomandime lidhur me komunitetet në Kosovë me qëllim që të nxisë, të mbështesë dhe të promovojë barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje, duke ndërmarrë, por duke mos u kufizuar në masat, si në vijim:
 - 1.1. ndihmon në organizimin dhe në artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikën dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
 - 1.2. u mundëson komuniteteve që të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe strategjive që u kushtohen pjesëtarëve të tyre, apo që kanë rëndësi të posaçme për to;
 - 1.3. rekomandon gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare, apo të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve, apo interesave të tyre të veçanta;
 - 1.4. kontribuon në raportimin e Qeverisë që u drejtohet mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, ngrë vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe kontribuon në

marrëdhëniet harmonike ndërmjet të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, si dhe

1.5. bashkëpunon me Qeverinë në organizimin e ditëve memoriale të komuniteteve.

V. Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete

1. Këshilli Konsultativ për Komunitete mbështetet nga Sekretariati, i vendosur në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Këshillit, i cili i përgjigjet dhe raporton drejtpërdrejt Presidentit për fushën që mbulon ky Sekretariat, ndërsa për çështje administrative i përgjigjet sekretarit të Zyrës së Presidentit.
3. Sekretari i Këshillit dhe të punësuarit e tjerë të Sekretariatit përzgjidhen, emërohen dhe shkarkohen në pajtim me dispozitat ligjore për nëpunësit civilë.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit janë, si në vijim:
 - 4.1. mbështet dhe promovon aktivitetet e Këshillit;
 - 4.2. mbështet Këshillin dhe grupet e tij punuese duke përfshirë organizimin e takimeve, përgatitjen e rendit të ditës dhe mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e tyre;
 - 4.3. ndihmon që Këshilli t'i përmbushë detyrimet e tij sipas Ligjit, sipas këtij statuti dhe sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 4.4. është përgjegjës për të planifikuar dhe për të menaxhuar me buxhetin e Këshillit;
 - 4.5. ndihmon Këshillin në dhënien e mendimeve në projekt legjislacionin dhe projekt dokumentet e politikave të përgatitura nga Qeveria dhe Kuvendi. Për realizimin e kësaj pike, Sekretariati bashkëpunon edhe me Departamentin për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 4.6. pranon dhe dërgon të gjitha shkresat dhe komunikimet e tjera zyrtare për të gjithë anëtarët e Këshillit;
 - 4.7. bën publikime për aktivitetet e Këshillit, kryen punët e informimit publik, si dhe përgjigjet në kërkesa për informata lidhur me punën e Këshillit;
 - 4.8. përfaqëson Presidencën në zbatimin e procedurave të nominimit, të përfshira në Ligj dhe në Statut.
 - 4.9. angazhohet në zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve për çështjen e komuniteteve dhe, sipas nevojës, kërkon këshilla nga ekspertë të jashtëm;
 - 4.10. mbështet kryerjen e çfarëdo funksioni tjetër të Këshillit në pajtim me Ligjin, me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

VI. Objektivat e punës për vitin 2024

Në zbatim të funksioneve dhe përgjegjësi të tij, Këshilli ka miratuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, në të cilin janë përcaktuar objektivat e punës, masat, aktivitetet, afatet për përmbushjen e tyre, institucionet dhe zyrtarët përgjegjës për zbatim.

Objektivat për vitin 2024

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e shtetit në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetet.
2. Thellimi i bashkëpunimit me institucionet në nivelin qendror dhe lokal dhe sektorit joqeveritar me rëndësi për komunitetet.
3. Informimi i përhershëm dhe me kohë i publikut me punën dhe aktivitetet e Këshillit.

VII. Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese

Nisur nga mandati, kompetencat dhe përgjegjësit kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara, si dhe në zbatim të Planit të Punës, siç u përshkruan në pikën IV, V dhe VI të këtij raporti, Këshilli gjatë vitit 2024, në mënyrë të organizuar dhe sipas dinamikës së paraparë, ka ndihmuar në organizimin dhe në artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre lidhur me legjislacionin, politikat dhe programet publike, që kanë rëndësi të veçantë për ta, duke ua ofruar mundësinë komuniteteve që, në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo politikave të cilat përgatiten nga institucionet e shtetit të Kosovës.

Në mënyrë të posaçme, Këshilli ka ngritur, ka trajtuar dhe ka analizuar çështje me interes për pjesëtarët e komuniteteve, siç është fusha e arsimit, punësimit, përdorimit të gjuhëve dhe kulturës.

Bazuar në analizën e kryer të trajtimit dhe shqyrtimit të spektrit të gjerë të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, Këshilli ka ngritur dhe ka kërkuar nga institucionet shtetërore të zbatojnë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës dhe praktikat më të mira të njohjes dhe respektimit të të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Takimet e Këshillit që kryesohen nga Presidentja

Këshilli takohet dy (2) herë në vit, nën kryesimin e Presidentes, për ta bërë një shqyrtim të përgjithshëm të politikave dhe shqetësimeve të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Sekretariati, në bashkëpunim me Kabinetin e Presidentes dhe me Këshillin, bën organizimin e takimeve që kryesohen nga Presidentja.



Takimi i Presidentes me Këshillin Konsultativ për Komunitete - takimi konstituiv me anëtarët e përbërjes së re për mandatin 2024-2026, është mbajtur më 10 dhjetor 2024.

Një pjesë e fjalimit të Presidentes znj. Vjosa Osmani Sadriu, në takimin me anëtarët e Këshillit.

Presidentja i përgëzoi anëtarët për zgjedhjen e tyre në përbërjen e re, si dhe ju dëshiroi sukses në punën e tyre gjatë mandatit të tyre dyvjeçar.

Presidentja, në diskutimin e saj më pas theksoi se, Këshilli Konsultativ për Komunitete është dëshmi e përkushtimit të Kosovës për ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët.

Presidentja, theksoi përkushtimin e saj të palëkundur për të siguruar që çdo qytetar, pa dallim etnie, feje apo gjuhe të ndihet pjesë e vlerësuar dhe aktive e shoqërisë së Kosovës.



Presidentja Osmani, ripohoi prioritetin e Presidencës për ta mbrojtur sigurinë dhe dinjitetin e çdo individi, duke siguruar që asnjë qytetar të mos marginalizohet apo diskriminohet.

Një Kosovë e sigurt për fëmijët tanë në një botë ku siguria çdo ditë e më shumë rrezikohet nga forca të errëta dhe destabilizuese është në synim që na bashkon të gjithëve. Ky është një prioritet dhe një angazhim i përditshëm. Ne duhet të ecim besimplotë drejt integritit, qoftë brenda vendit, qoftë në proceset euroatlantike.

Në përfundim të fjalës së saj, Presidentja nënvizoi se fuqizimi i komuniteteve është një përgjegjësi institucionale dhe një angazhim i drejtë që fuqizon shtetin tonë.

Pas përfundimit të fjalimit, Presidentja ju dëshiroi sukses anëtarëve në mbarëvajtjen dhe vazhdimin e punës.

Në vazhdim të takimit, Këshilli ka zgjedhur kryesinë në këtë përbërje: Kryesues, z. Izudin Sagdati, përfaqësues nga komuniteti boshnjak, zëvendës kryesuese e parë, znj. Alisa Avdi, përfaqësuese nga komuniteti rom dhe zëvendës kryesuesi tjetër, z. Miloš Arsić, përfaqësues nga komuniteti serb.



Takimi i fundvitit i Këshillit Konsultativ për Komunitete me Presidenten është mbajtur më 27 dhjetor 2024.

Presidentja e Republikës së Kosovës, në fundvit ka pritur anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe një grup fëmijësh nga të gjitha komunitetet.



Presidentja i falënderoi anëtarët për pjesëmarrje në takim të fundivitetit, si dhe theksoi: Kam kënaqësinë në fundvit, të mirëpres edhe anëtarët e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe një grup fëmijësh nga të gjitha komunitetet. Kosova i përket të gjithë qytetarëve të saj, por mbi të gjitha fëmijëve tanë – gjeneratës së ardhshme të udhëheqësve. Së bashku për një Kosovë të barabartë për të gjithë.

Takimet e rregullta të Këshillit

Këshilli takohet një (1) herë në muaj.

Takimet e Këshillit i thërret dhe i udhëheq kryesuesi i Këshillit, në mungesë të tij, njëri nga zëvendës kryesuesit e tij.

Këshilli gjatë vitit 2024 ka mbajtur takimet e rregullta mujore, gjithsej dymbëdhjetë (12) takime.

Takimet e Këshillit, të grupeve punuese si dhe aktivitetet e tjera të realizuar për gjatë vitit 2024 do të paraqiten në mënyrë kronologjike në vijim:

Janar

Më 25 janar 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Gjatë këtij muaji është takuar një (1) grup punues i Këshillit:

- Grupi Punues për Legjislacion.

Në takim Këshilli ka shqyrtuar dhe miratuar propozim rekomandimin për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe propozim komentet e Grupit Punues për Legjislacion në Strategjinë e Punësimit – Kosovë 2023 - 2027.

Komentet në Strategjinë e Punësimit – Kosovë 2023-2027

Të adresohet mungesa absolute e referencave për komunitetet jo shumicë në këtë Strategji.

Duke e ditur që: prej statistikave të Agjencisë së Republikës së Kosovës, si dhe prej raporteve dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe të BE-së dhe shumë akterë të tjerë, se komunitetet përbëjnë një grup të cenueshëm sa i përket qasjes në tregun e punës dhe nivelit të punësimit, për këtë arsye propozojmë dy ndryshime substanciale në Strategji.

Që çdo herë kur përmenden grupe të marginalizuara dhe të nënpunësuar, siç përmenden shpesh dhe me vend, në shumë pjesë të raportit, duhet të përfshihen jo vetëm gratë, rinia, persona me nevoja të veçanta etj, por duhet të përfshihen edhe pjesëtarët që vijnë nga komunitetet jo shumicë.

Që çdo herë kur përdoren shifra për të identifikuar nevoja specifike për masat për punësim, analiza të bëhet në baza etnike dhe jo vetëm gjinisë, pasi që është faktor kyç që kontribuon në nivelin e ulët të punësimit, si psh. në statistika për varfëri në faqen 7,

2.2. tendencat për pjesëmarrje në arsim;

2.3.1. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore;

2.3.2. Tendencat e punësimit;

2.3.4. Pagat dhe kushtet e tjera të punës;

2.3.5. Papunësia – Statistikat e papunësisë;

2.3.6, Inaktiviteti dhe dekurajimi;

3.2. Politikat e arsimit dhe trajnimit, shkalla e përfundimit të Bachelor;

3.3.3. Të regjistruar në Agjencinë e Punësimit;

4.4.1. Statistika për NET;

Rezultati për punësim të përkohshëm si dhe Raporti punësim – popullsi i grupeve në rrezik, tabela 7.

Në faqen 55, **Grupi Këshillues si grup që do të:**

Shqyrtojë progresin dhe raportet e monitorimit të përgatitura nga departamenti i Punësimit përpara dërgimit të tyre në Qeveri;

Këshillojë për shqetësimet e shfaqura në fushën e punësimit që duhet të adresohen në kuadrin kohor të Strategjisë; dhe

Riformulojë, në bazë të gjetjeve të raporteve të vlerësimit, objektivat specifike, synimet dhe rezultatet e politikave, sipas nevojës.

E vlerësojmë se është me shumë rëndësi që ky grup do të ketë përfaqësim prej një trupi qeveritar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, qoftë prej Këshillit Konsultativ për Komunitete, qoftë prej Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, qoftë prej Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit.

- **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, na ka njoftuar për pranimin e komenteve të dërguara nga Këshilli, si dhe për përfshirjen e tyre në Strategjinë e Punësimit – Kosovë 2024 – 2028.**

Rekomandimi i Këshillit për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Secili ofrues publik i mbështetjes financiare që shpall thirrje publike për mbështetje financiare në përbërjen e Komisionit Vlerësues të ketë së paku një (1) përfaqësues nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

Të gjitha fazat e thirrjes publike, nga përgatitja e thirrjes deri në nënshkrimin e kontratës dhe monitorimi, duhet të kryhen njëkohësisht në të dyja gjuhët zyrtare, në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Në përputhje me Ligjin për Përdorimin e gjuhëve, i gjithë dokumentacioni përcjellës duhet të jetë dygjuhësh.

Çdo thirrje për grante duhet të përcaktojë shumën minimale të mjeteve që do t'iu jepen organizatave që vijnë nga komunitetet dhe që kanë një portofol të dëshmuar të aktiviteteve në komunitet.

Plotësim Ndryshimi i Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, sepse shkak i të gjitha gabimeve të konstatuara qëndron pikërisht në paqartësitë në këtë rregullore, përkatësisht në interpretimet e saj negative. Për t'i shmangur interpretimet që i shkelin të drejtat e komuniteteve, kjo rregullore duhet të ndryshohet për t'i mbrojtur interesat e komuniteteve joshumicë. Besojmë se ndryshimi i kësaj Rregulloreje duhet të nënkuptojë integrimin e komenteve të mëparshme në tekstin e Rregullores.

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, nuk ka kthyer përgjigje në rekomandimin e dërguar nga Këshilli.

Anëtari i Këshillit, z. Agim Ferati më 29 janar 2024, ka marrë pjesë në takimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Shkurt

Më 29 shkurt 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Gjatë këtij muaji janë takuar tri (3) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Kulturës.

Në takim z. Agim Ferati, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Qendror të Regjistrimit (KQR), i ka informuar anëtarët e Këshillit lidhur me përgatitjet për procesin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë.

Përfaqësuesit e komunitetit turk në Këshill, z. Atakan Koro dhe znj. Sevim Bërveniku, më 10 shkurt 2024 në Mitrovicë, kanë organizuar një takim me organizatat përfaqësuese të komunitetit turk, pjesëmarrëse në procesin e nominimit dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare nga Mitrovica, Vushtrria, Prishtina dhe Prizreni.

Z. Atakan Koro dhe znj. Sevim Bërveniku i kanë njoftuar përfaqësuesit e organizatave për strukturën, organizimin, funksionimin dhe punën e Këshillit. Pjesëtarët e komunitetit turk të pranishëm në takim kanë prezantuar sfidat dhe problemet me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit në të gjitha fushate jetës. Z. Koro dhe znj. Bërveniku, pas dëgjimit për sfidat dhe shqetësimet me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit turk, janë shprehur se do të angazhohen për të ofruar kontributin e tyre në adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të ngritura në takim.

Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro dhe anëtarja e Këshillit, znj. Sevim Bërveniku, më 14 shkurt 2024, kanë pritur në takim z. Enis Kervan dhe znj. Fidan Brina Jilta, deputetë të komunitetit turk në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në takim, janë diskutuar sfidat me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, si dhe mundësitë e bashkëpunimit në adresimin dhe zgjidhjen e këtyre sfidave.

Kryesuesja e Grupit Punues për Çështje të Arsimit, znj. Dževahira Kolenović, më 15 shkurt 2024, ka marrë pjesë në takimin e përbashkët me akterët në nivel ndërkombëtar dhe vendor, të përkushtuar në ndërtimin e paqes dhe besimit në Kosovë, të organizuar nga UNICEF në Kosovë dhe Organizata për Migrim (IOM). Në takim është prezantuar projekti i ri i Fondit për Ndërtimin e Paqes, i zbatuar nga UNICEF dhe IOM, si dhe është diskutuar për shkëmbimin e përvojave, identifikimin e sinergjive dhe shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim.

Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaš, dhe zyrtarët e Sekretariatit, më 15 shkurt 2024, kanë realizuar një takim me përfaqësuesit e OSBE-së, znj. Shqipe Hajredini, znj. Valentina Pancaldi dhe z. Visar Hamza, me të cilët kanë diskutuar për aktivitetet e përbashkëta që mund të realizohen gjatë vitit 2024, duke u fokusuar në temat që janë me rëndësi dhe interes për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, si çështjet në fushën e arsimit, sociale dhe të punësimit. Takimi është realizuar përmes platformës Zoom.

Anëtari i Këshillit, z. Agim Ferati më 27 shkurt 2024, ka marrë pjesë në takimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Më 29 shkurt – 02 mars 2024 kryesia e Këshillit, kryesuesit e grupeve punuese dhe zyrtarët e Sekretariatit të Këshillit kanë marrë pjesë në punëtorinë e organizuar në Gjilan për hartimin e propozim raportit vjetor të punës së Këshillit për vitin 2023.

Mars

Më 28 mars 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit në takim kanë shqyrtuar dhe miratuar propozim raportin vjetor të punës së Këshillit për vitin 2023.

Në takim, anëtarët e Këshillit janë informuar nga z. Avni Kastrati, u.d. Kryeshef në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, lidhur me përgatitjet për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaş, dhe zyrtarët e Sekretariatit, më 07 mars 2024, kanë pritur në takim përfaqësuesit e OSBE-së, znj. Shqipe Hajredini, znj. Valentina Pancaldi dhe z. Visar Hamza, me të cilët kanë diskutuar për aktivitetet e përbashkëta të cilat mund të realizohen gjatë vitit 2024. Pjesëmarrësit në takim janë pajtuar për organizimin e një punëtorie njëditore në fushën e arsimit në të cilën do të trajtohen temat e teksteve shkollore dhe braktisjes së shkollës nga nxënësit e komuniteteve jo shumicë.

Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro, Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaş, dhe zyrtari i Sekretariatit, z. Zijush Ahmeti, më 08 mars 2024, janë pritur në takim në Institucionin e Avokatit të Popullit nga z. Naim Qelaj. Gjatë takimit, z. Atakan Koro, e ka informuar z. Qelaj për sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Avokati i Popullit ka shprehur gatishmërinë e tij për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Këshillit

Konsultativ për Komunitete në të ardhmen, me qëllim të angazhimit të përbashkët për zbatimin sa më të mirë të legjislacionit nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Anëtari i Këshillit, z. Ibrahim Ömer dhe zyrtari i Sekretariatit, z. Zijush Ahmeti, më 12 mars 2024, janë pritur në takim nga z. Bleri Sallahu, Zëvendësministër në Ministrinë e Drejtësisë. Në takim, z. Ibrahim Ömer ka diskutuar çështjen e përfaqësimit dhe punësimit të pjesëtarëve të komunitetit turk në gjykata dhe si avokat, si dhe mundësinë e organizimit të testit për provimin e jurisprudencës në gjuhën turke. Zëvendësministri në takim theksoi se, aktualisht ka të punësuar pjesëtarë të komunitetit turk në gjykata, por përfaqësimi në numër më të madh në të ardhmen është i mirëpritur. Gjithashtu, shprehi gatishmërinë për të mundësuar edhe testin për provimin e jurisprudencës në gjuhën turke.

Anëtari i Këshillit, z. Agim Ferati më 12 mars 2024, ka marrë pjesë në takimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Prill

Më 25 prill 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Në takim, anëtarët e Këshillit kanë diskutuar dhe shprehur pakënaqësitë ndaj Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, lidhur me mënyrën e organizimit dhe shënimit për ditët e komuniteteve.

Gjatë këtij muaji është takuar një (1) grup punues i Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve.

Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaş, dhe zyrtari i Sekretariatit z. Zijush Ahmeti, më 03 prill 2024, kanë pritur në takim znj. Violeta Ademi dhe znj. Arjeta Galimuna, përfaqësuese të programit "Young Cell Scheme Raundet XIII- XIV-XV", një program bursash për studime master i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës, i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe i zbatuar nga Konsorciumi: Universiteti Aristotel i Selanikut dhe Instituti Kombëtar për Shërbime Publike në Francë. Në takim znj. Violeta dhe znj. Arjeta prezantuan detajet e programit, kriteret e aplikimit dhe përfitimet e ofruara nga Skema "Young Cell Scheme" Raundi XIV, si dhe u diskutua për mundësinë e përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve në këtë program bursash për studime master me financim të plotë.

Zyrtari i Sekretariatit, z. Zijush Ahmeti, më 24 prill 2024, ka marrë pjesë në takimin e Grupit Teknik të Punës për koordinimin e zbatimit të rekomandimeve të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave.

Anëtarja e Këshillit, znj. Mirjeta Qehaja, më 29 prill 2024, ka marrë pjesë në takimin e Grupit Punues Ndërinstitucional për raportimin dhe parandalimin e martesës së hershme të komunitetëve rom, ashkali dhe egjiptian.

Më 29 prill 2024, në Prishtinë, Grupi Punues për Çështje të Arsimit, në bashkëpunim dhe me mbështetjen nga OSBE-ja, ka organizuar punëtorinë me temën: " Gjendja në arsim për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës". Qëllimi i organizimit dhe mbajtjes së punëtorisë ishte informimi dhe diskutimi lidhur me sfidat dhe nevojat për tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë (komunitetet boshnjak dhe turk), braktisjen e shkollës dhe qendrat mësimore (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian), si dhe zbatimin e legjislacionit dhe veprimet e ndërmarra nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për zgjidhjen e tyre.

Punëtorja u zhvillua në dy sesione dhe u moderua nga znj. Shqipe Hajredini (OSBE).

Në sesionin e mëngjesit, në temën " Tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve jo shumicë (komunitetet boshnjakë dhe turk në Kosovë) - sfidat dhe nevojat" prezantuan:

- Znj. Valentina Pancaldi (OSBE)
- Z. Atakan Koro (Kryesues i Këshillit Konsultativ për Komunitete)
- Znj. Dževahira Kolenović (Kryesuese e Grupit Punues për Çështje të Arsimit)
- Znj. Fehime Llapashtica (Udhëheqëse e Divizionit për Planprograme dhe Tekste Shkollore)
- Znj. Shqipe Gashi Ramadani (Divizioni për Kurrikula dhe Tekste Mësimore)

- Znj. Habibe Buzuku (Kryesuese e Këshillit të Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore).

Në sesionin e pasdites, në temën " Braktisja e shkollës (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian) – sfidat dhe nevojat", prezantuan:

- Z. Artan Kosumi (OSBE)
- Z. Sunaj Garipi (përfaqësues i komunitetit rom në Këshill)
- Z. Bajram Ilazi (përfaqësues o komunitetit ashkali në Këshill)
- Z. Blerim Shala (përfaqësues i komunitetit egjiptian në Këshill)
- Znj. Merita Jonuzi (Udhëheqëse e Divizionit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore)

Maj

Më 30 maj 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Në takim Këshilli ka shqyrtuar dhe miratuar propozim rekomandimin për Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe propozim komentet në Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-095 Për Akademinë e Drejtësisë, Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-056 Për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-055 Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe Projektligjin për Nëpunësit Civil në Administratën e Gjykatave dhe Prokurorive.

Komentet në Projektligjin Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-095 Për Akademinë e Drejtësisë

Neni 3

Neni 8 i Ligjit Bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 8 Këshilli Drejtues i Akademisë

Paragrafi 1, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim

1. Këshilli Drejtues i Akademisë, (më tej: Këshilli Drejtues) mbikëqyrë Akademinë dhe përbëhet nga nëntë (9) anëtarë nga institucionet e mëposhtme: **Së paku një (1) prej tyre të jetë pjesëtarë i komuniteteve jo shumicë.**

Neni 8

Neni 15 i Ligjit Bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 15 Përbërja e Këshillit Programor

Paragrafi 1, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim

1. Këshilli Programor përbëhet prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve, të cilët i përzgjedh Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë, ne bazë të një konkursi të hapur siç parashihet me nenin 15/A të këtij Ligji. **Së paku dy (2) prej tyre të jenë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë.**

Neni 11

Neni 18 i Ligjit Bazik, ndryshohet si në vijim:

“Neni 18 Kriteret, emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë

Paragrafi 1, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim

1. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë bëhet nga Këshilli Drejtues në pajtim me dispozitat që rregullojnë pozitat e nivelit të lartë drejtues sipas Ligjit përkatës për zyrtarët publik. **Një (1) zëvendës drejtor të jetë nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.**

Komentet në Projektligjin Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-056 Për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Neni 3

Neni 27 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim

Neni 27

Vlerësimi i performancës

Paragrafi 4, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim:

4.Përbërja e Komisionit pasqyron përbërjen etnike dhe gjinore sipas legjislacionit në fuqi.

Së paku një (1) anëtarë i Komisionit të jetë nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

Neni 27E

Zyrtarët e njësive për kontrollin e integritetit

Paragrafi 4, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim:

4.Secila njësi ka së paku shtatë (7) zyrtarë profesional të punësuar dhe udhëheqësin e Njesisë. **Së paku një (1) prej tyre të jetë nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.**

Komenti në Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-055 Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Neni 27

Vlerësimi i performancës

Paragrafi 4, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim:

4.Përbërja e Komisionit pasqyron përbërjen etnike dhe gjinore sipas legjislacionit në fuqi.

Së paku dy (2) prej anëtarëve të Komisionit duhet të jenë nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

Komentet në Projektligjin për Nëpunësit Civil në Administratën e Gjykatave dhe Prokurorive.

Neni 5

Struktura organizative dhe administrimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive

Të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim:

Struktura organizative, klasifikimi i vendeve të punës dhe organogrami i njësive rregullohet me akte nënligjore të nxjerra nga KGJK dhe KPK. **Të sigurohet pjesëmarrja nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë së paku 10%, si dhe përfaqësimi proporcional i tyre.**

Neni 6 Administrimi i stafit civil

Të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim:

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit është përgjegjës për menagjimin dhe funksionimin efektiv të shërbimit civil në administratën e gjykatave dhe prokurorive. **Zëvendës drejtori të jetë nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.**

- Ministria e Drejtësisë, na ka njoftuar për pranimin e komenteve të dërguara nga Këshilli, si dhe ka falënderuar për bashkëpunimin, dhe përgjigjen se komentet do të shqyrtohen nga grupi punues në ministri, por jo ndonjë përgjigje më të detajuar lidhur me përfshirjen apo mos përfshirjen e komenteve të dërguara nga Këshilli.

Rekomandimi i Këshillit për Administratën Tatimore të Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës:

T'i ofrojë të gjithë formularët në faqen zyrtare (sistemi EDI) për shërbimet elektronike për përdoruesit në të dyja gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, të gjitha format për raportimin financiar vjetor në ueb-faqen (sistemi EDI) për ofrimin e shërbimeve elektronike duhet të përkthehen dhe të publikohen në të dyja gjuhët zyrtare në Kosovë.

- Administrata Tatimore e Kosovës nuk na ka kthyer përgjigje në rekomandimin e dërguar nga Këshilli.

Përfaqësuesit e komunitetit turk në Këshill, z. Atakan Koro dhe z. Ibrahim Ömer, më 05 maj 2024 në Gjilan, kanë organizuar takim me organizatat përfaqësuese të komunitetit turk nga Gjilani, Doburçani, Prishtina dhe Prizreni. Në takim z. Koro dhe z. Ömer i kanë njoftuar përfaqësuesit e komunitetit turk për punën e Këshillit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes Këshillit dhe organizatave përfaqësuese me institucionet e nivelit lokal dhe qendror për adresimin e sfidave të përbashkëta. Pjesëmarrësit në takim kanë shprehur shqetësimet e tyre, si dhe kanë theksuar nevojën për angazhim të përbashkët në zgjidhjen e problemeve që prekin komunitetin turk. Z. Koro dhe z. Ömer në takim kanë konfirmuar angazhimin e tyre

të plotë për të punuar së bashku me të gjitha palët e interesuara për të gjetur zgjidhje konkrete dhe për të avancuar çështjet që janë me interes për komunitetin turk.

Më 07 maj 2024, Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaş, ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe GIZ-i gjerman me temën "Si mund të përfitojnë komunitetet jo shumicë nga zvogëlimi i barrës administrative", e cila u vlerësua si një hap i rëndësishëm për të siguruar që të gjitha komunitetet në Kosovë të kenë mundësi të barabarta për të përfituar nga shërbimet dhe burimet qeveritare.

Qershor

Këshilli më 27 qershor 2024, ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Zëvendës kryesuesja e Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro, dhe tre përfaqësuesit e komunitetit boshnjak në Këshill, z. Agim Ferati, znj. Dževahira Klenović dhe z. Almedin Fejza, me ftesë të Zyrës për Koordinim të Këshillave Boshnjake, nga data 27-30 qershor 2024 kanë realizuar vizitë zyrtare në Bihaq, Bosnje dhe Hercegovinë.

Korrik

Më 25 korrik 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Këshilli në takim ka shqyrtuar dhe miratuar propozim komentin në Projekt Rregulloren (MPB) NR. 00/12 Për Themelimin, Përbërjen, Mandatin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave për OJQ-të.

Komenti në Projekt Rregulloren

Neni 4

Përbërja, Emërimi dhe Mandati i anëtarëve të Komisionit të Ankesave

Paragrafi 2 i këtij neni, të ndryshohet dhe të plotësohet me tekstin si në vijim:

1. Komisioni i Ankesave për DOJQ-në formohet me Vendim të Ministrit.
2. Komisioni i Ankesave përbëhet prej tre (3) anëtarëve, së paku një (1) prej të cilëve jurist, **dhe një (1) pjesëtar i komuniteteve jo shumicë.**

Ministria e Punëve të Brendshme, na ka njoftuar për pranimin e komentit të dërguar nga Këshilli, si dhe për përfshirjen e tyre në Projekt Rregulloren (MPB) NR. 00/12 Për Themelimin, Përbërjen, Mandatin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave për OJQ-të.

Anëtari i Këshillit, z. Slaviša Mladenović, në takim i ka informuar anëtarët lidhur me propozim programin për komunitete në përgatitje e sipër nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro, anëtari i Këshillit, z. Ibrahim Ömer, dhe zyrtari i Sekretariatit, z. Sead Bardhi, me ftesë nga Konfederata e Turqve Rumeli të Ballkanit, nga data 26 – 28 korrik 2024, kanë realizuar vizitë zyrtare në Bursa, Turqi.

Gusht

Më 29 gusht 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit. Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro, ka kërkuar në takim nga grupet punuese që të angazhohen më tepër gjatë dy muajve të ardhshëm të cilat kanë mbetur deri në fund të mandatit.

Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro, me ftesë të Fondacionit Turan në Hungari, nga data 8 -10 gusht 2024, ka realizuar vizitë zyrtare në Hungari.

Shtator

Më 26 shtator 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve të Këshillit lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Kryesuesi i Këshillit, z. Atakan Koro, dhe tre përfaqësuesit e komunitetit boshnjak në Këshill, z. Agim Ferati, znj. Dževahira Kolenović, dhe z. Almedin Fejza, si dhe zyrtari i Sekretariatit të Këshillit, z. Sead Bardhi, me ftesë të Zyrës për Koordinim të Këshillave Boshnjake të Kroacisë, nga data 27 – 30 shtator 2024, kanë realizuar vizitë zyrtare në Zagreb, Kroaci.

Tetor

Më 31 tetor 2024, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.



Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve të Këshillit lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Në takim znj. Manuela Petrović nga Zyra për Çështje të Komuniteteve, ka prezantuar para anëtarëve të Këshillit platformën e cila përmban informata dhe të dhëna në dobi të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Përfaqësuesja e Presidentes në Këshill znj. Donika Kadaj Bujupi, Sekretarja e Këshillit znj. Nafiye Gaş, si dhe zyrtarët e Sekretariatit të Këshillit z. Zijush Ahmeti dhe z. Sead Bardhi, nga data 20-24 tetor 2024, me ftesë të Presidentit të Federatës së Shoqatave Ballkanike të Rumelisë, z. Kamuran Atakan, kanë realizuar vizitë në Stamboll, Turqi. Gjatë vizitës janë realizuar këto takime:

- Të hënën, më 21 tetor 2024, në ora 11:00, takim me z. Osman Atalay, Themelues i Fondacionit për Ndihma Humanitare (IHH) dhe z. Mariglen Shehu – Koordinator për Amerikë dhe Evropë i IHH-së;
- Të hënën, më 21 tetor 2024, pjesëmarrja në ceremoninë e ndarjes së çmimeve "Best of Rumeli 2024, të organizuar nga Federata e Shoqatave Ballkanike Rumeli në Cemal Reşit Rey - Şişli.
- Të martën, më 23 tetor 2024, takim me z. Ilker Nişlioğlu, analist dhe përgjegjës për Republikën e Kosovës në Qendrën për Hulumtime Strategjike Ballkanike Rumeli (RUBASAM);
- Të mërkurën, më 23 tetor, takim me Konsullen e përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stamboll, zj. Suzan Nobërdaliu.

Grupet Punuese të Këshillit

1. Këshilli mund të formojë grupe punuese, të cilat përbëhen më së shumti deri në pesë (5) anëtarë, me qëllim të avancimit të punës për çështje konkrete, apo për fusha specifike të Këshillit.
2. Këshilli do t'i zgjedhë anëtarët e grupeve punuese nga specialistë të fushave të veçanta për të punuar në çështjen specifike për të cilën një grup është themeluar.
3. Grupet punuese raportojnë në takime të rregullta të Këshillit për zbatimin e mandatit dhe aktiviteteteve të tyre dhe dorëzojnë raporte dhe rekomandime për miratim në Këshill.
4. Grupet punues e pasqyrojnë përbërjen gjinore dhe atë të komuniteteve.
5. Grupet punuese diskutojnë dhe trajtojnë çështje për të cilat vlerësojnë se janë të rëndësishme dhe me interes për komunitetet në takimet e tyre dhe për çështjet e diskutuara dhe të trajtuara informojnë në takimet e rregullta të Këshillit, duke ofruar edhe propozime konkrete për adresimin e çështjeve të diskutuara.
6. Secili grup punues zgjedh kryesuesin e vet dhe një (1) zëvendës kryesues nga mesi i anëtarëve të rregullt të Këshillit që përfaqësojnë komunitetet.

Në kuadër të Këshillit janë të formuara pesë (5) grupe punuese.

Grupi Punues për Çështje të Arsimit

Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale

Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve

Grupi Punues për Çështje të Kulturës

Grupi Punues për Legjislacion.

Grupi Punues për Çështje të Arsimit ka mbajtur dy (2) takime, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje lidhur me:

- Diskutim lidhur me aktivitetet e grupit punues për vitin 2024;
- Zgjedhja e Kryesuesit të Grupit Punues;
- Organizimin e tryezës së rrumbullakët me temën “Gjendja në arsim për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komunat e Republikës së Kosovës”;
- Diskutim lidhur me tekstet shkollore për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.



Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale ka mbajtur një (1) takim, në të cilin janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje lidhur me:

- Diskutim lidhur me aktivitetet e grupit punues për vitin 2024;
- Zgjedhja e kryesuesit të Grupit Punues.



Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve ka mbajtur një (1) takim, në të cilin janë shqyrtuar dhe diskutuar çështje lidhur me:

- Shqyrtimi i projekt rregullores për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit;
- Shqyrtimi i rekomandimit për Administratën Tatimore të Kosovës.



Grupi Punues për Çështje të Kulturës ka mbajtur një (1) takim, në të cilat janë diskutuar çështje lidhur me:

- Diskutim lidhur me aktivitetet e grupit punues për vitin 2024.



Grupi Punues për Legjislacion ka mbajtur një (1) takim, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar çështjet përkatëse lidhur me:

- Shqyrtimin e Programit Legjislativ për Vitin 2024;
- Shqyrtimin e rekomandimit për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Shqyrtimin e Strategjisë së Punësimit - Kosovë 2024 - 2028.



Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit

Sekretariati i Këshillit, në zbatim të përgjegjësive dhe detyrave, siç janë përshkruar edhe në pikën V të këtij Raporti, ka punuar me përkushtim në përmbushjen e tyre, me kohë ka arritur të sigurojë shërbimet profesionale dhe administrative për Këshillin dhe grupet punuese të tij.

Angazhimi i Sekretares dhe stafit të Sekretariatit ka qenë i fokusuar në organizimin dhe në mbarëvajtjen e dhjetë (10) takimeve të rregullta të Këshillit, takimit konstituiv dhe takimit të fundvitit, një (1) takimi të kryesisë së Këshillit dhe gjashtë (6) takime të grupeve punuese, gjithsej tetëmbëdhjetë (18) takime

Në konsultim me kryesinë e Këshillit, kryesuesit e grupeve punuese kanë përgatitur ftesat me rendin e ditës dhe materialin tjetër përcjellës, të cilat në afatin e duhur kohor i janë dërguar anëtarëve të Këshillit, përkatësisht anëtarëve të grupeve punuese.

Kanë përpiluar komunikatat për shtyp, procesverbalet, vendimet dhe rekomandimet nga takimet e lartpërmendura.

Kanë këshilluar anëtarët e Këshillit, në çështjet e ngritura për trajtim si dhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me punën dhe mandatin e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Janë përkujdesur që të sigurohet dhe të realizohet në mënyrë të kënaqshme bashkëpunimi përveç me institucionet shtetërore edhe me mediat, organizatat ndërkombëtare, me OJQ-të dhe përfaqësues të tjerë të nivelit komunal, si me Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe Komitetet për Komunitete në komuna.

Sekretariati në bashkëpunim me Zyrën e Presidentes të Republikës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, ka menaxhuar dhe ekzekutuar me sukses pjesën e buxhetit që i përket Këshillit.

VIII - Organizimi i Seancave të Nominimit me Organizatat Përfaqësuese të Komuniteteve

Bazuar në Statutin e Sekretariatit të Këshillit, Sekretariati ka organizuar seancat e nominimit me Organizatat Përfaqësuese të komuniteteve, si në vijim:

Në Prishtinë, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit malazez, më 20 shtator 2024.



Në Prishtinë, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit rom, më 20 shtator 2024.



Në Prishtinë, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit ashkali, më 20 shtator 2024.



Në Prishtinë, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit turk, më 24 shtator 2024.



Në Prishtinë, më 24 shtator 2024, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit serb.



Në Dragash, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit goran, më 25 shtator 2024.



Në Prizren, Seanca e Nominimit me organizatat përfaqësuese të komunitetit boshnjak, më 25 shtator 2024.



IX Buxheti i Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe raporti financiar

1. Buxheti i Këshillit

Në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit, Këshilli e ka kodin e vet buxhetor në kuadër të buxhetit të Zyrës së Presidentes.

Zyra e Presidentit, me rastin e përcaktimit të shumës së buxhetit vjetor, merr parasysh propozimet e Këshillit.

2. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive

Në kategorinë paga dhe mëditje, janë ndarë 56,994.00 €, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime janë ndarë 82,390.00 €. Vetëm për pagat, përfshirë kontributin pensional dhe tatimin e ndalur në të ardhurat personale, janë paguar në total 58,643.22 €. Buxheti për paga dhe mëditje shprehur në përqindje është shpenzuar 102.89%, ndërsa, në kategorinë mallra dhe shërbime, nga 82,390.00 € sa janë alokuar, janë shpenzuar 82,277.12 €, apo shprehur në përqindje 99.86%. Nga kjo shumë vetëm për pagesën e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit, përfshirë kontributin pensional dhe tatimin e ndalur në të ardhurat personale janë paguar 71,265.34 €, kurse për shpenzimet për shërbimet (përkthime, zërimi, mirëmbajtja e web faqes, shpenzimet e përfaqësimit – reprezentacionit, etj.) janë shpenzuar 3,671.89 €. Pjesa tjetër e buxhetit 7,339.89 € është shpenzuar për mbulimin e nevojave të tjera ndërlidhura me aktivitetet e Këshillit, grupeve punuese, siç janë shpenzimet e udhëtimeve brenda dhe jashtë vendit (mëditjet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendi, akomodimi brenda dhe jashtë vendi etj.), si dhe bashkëpunimeve ndërinstitucionale, ngritjen e kapaciteteve, dhe shpenzimet e tjera lidhur me furnizimet dhe punën në zyrë. Në total janë shpenzuar 140,920.34 €, nga të alokuara 139,384.00 €, apo shprehur në përqindje 101.10 % e buxhetit të aprovuar për vitin fiskal 2024 (pjesa e buxhetit 1.10% që tejkalon 100% e buxhetit të Këshillit është siguruar nga buxheti i ZPRK-së).

Kategoria e Buxhetit	Buxheti i alokuar	Buxheti i shpenzuar	Shpenzimet në %
Paga dhe mëditje	56,994.00 €	58,643.22 €	102.89%
Mallra dhe shërbime	82,390.00 €	82,277.12 €	99.86%
Total	139,384.00 €	140,920.34 €	101.10%

Shpenzimet sipas kategorive buxhetore

Kategoria e Buxhetit	Kompensimi mujor të anëtarëve, tatime në të ardhurat dhe kontribute	Shpenzimet për shërbimet	Shpenzime tjera
Mallra dhe shërbime	71,265.34 €	3,671.89 €	7,339.89 €

Shpenzimet nga kategoria mallra dhe shërbime

3. Ekzekutimi i buxhetit

Kërkesat për ekzekutimin e pagave, mëditjeve dhe sigurimin e shërbimeve për plotësimin e nevojave të anëtarëve të Këshillit dhe të Sekretariatit, parashtrohen nga ana e Sekretares së Këshillit, ndërsa ekzekutimi i kërkesave bëhet përmes zhvillimit të procedurave nga ana e zyrtarëve përkatës profesional të Zyrës së Presidentes.

Bashkëpunimi me zyrtarët përkatës të Zyrës së Presidentes dhe ekzekutimi i buxhetit nga ana e tyre, sipas kërkesave të Sekretariatit, është zhvilluar në përputhje me procedurat në fuqi dhe në afatet e caktuara.

VIII. Përfundime

Bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, në përputhje me kapacitetet dhe me mundësitë buxhetore, Këshilli në masën më të madhe ka arritur objektivat e përcaktuara në planin vjetor të punës për vitin 2024.

Të gjithë anëtarët e Këshillit kanë vijuar me punë në përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor.

Të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësinë e tyre, anëtarët e Këshillit mbeten të përkushtuar që, edhe për gjatë vitit 2025, të vazhdojnë të jenë të angazhuar në thellimin e bashkëpunimit me të gjitha institucionet relevante të vendit, si dhe të zgjerojnë bashkëpunimin me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare për të siguruar promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e barazisë së plotë dhe efektive për të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre në Republikën e Kosovës.

Sfidat e Këshillit për gjatë vitit 2024:

Sfidat:

Mungesa e kuorumit për mbajtjen e takimeve të grupeve punuese.